



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Nr.....Prot.

Vlorë, më 18.01.2017

URDHER NJOFTIMI

Lënda: Njoftim aplikimi per personel akademik me angazhim të plotë ne Universitetin "Ismail Qemali"

Drejtuar: Fakultetit te Shkencave Teknike
Zyres se Burimeve Njerezore
Drejtorese se Komunikimit
Drejtorese se IT-se

Ne mbeshtetje te nenit 64 te ligjit Nr. 80/2015 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", te ligjit Nr. 9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", Per buxhetin e Vitit 2017", neneve 40, 43, 44, 45, 46, te Statutit dhe neneve 27, 28, 29, 30 te Rregullores se Universitetit "Ismail Qemali" Vlore, referuar shkreses me nr. prot. 29/2, date 17.01.2017 te Dekanit te Fakultetit te Shkencave Teknike, te Vendimit nr.3 date 13.03.2017 të Senatit Akademik, domosdoshmerisht per plotesimin e nevojave dhe sigurimit te standarteve te cilesise ne mesimdhenie ne Departamentin e Kimisë,

URDHEROJ:

1. Te behet shpallja e njoftimit te vendeve te lira te punes per personel akademik me angazhim te plotë ne Departamentin e Kimisë, ne perputhje me procedurat e parashikuara ne ligjin Nr. 80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe kerkimin Shkencor ne Institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise", Statutit dhe Rregullores se Universitetit "Ismail Qemali" Vlore.
2. Bashkelidhur keni njoftimin zyrtar.

Prof.Dr. Roland ZISI

R E K T O R I



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

NJOFTIM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, shpall konkursin per 1 vend i lirë pune per personel akademik ne Departamentin e Kimise, prane Fakultetit te Shkencave Teknike, per vitin akademik 2016-2017.

A. Të interesuarit për vendet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:

1. Të kete domosdoshmerisht Diplomen “ Master I Shkencave) ne fushen e Kimi me mesatare jo me pak se 8.5 (tete pike pese).
2. Kandidati duhet te zoteroje diplomen Bachelor ne fushen e Kimise me mesatare jo me pak se 8.5 (tetpikë pese), kandidati duhet te zoteroje diplomen DIND ne fushen e Kimise me mesatare jo me pak se 8.
3. Preferohen kandidatet te cilet kane fituar graden Prof.Dr ose Prof.As ne fushen e Kimise. Kandidatet te cilet kane fituar graden Doktor I shkencave ne fushen e Kimise..Kandidat qe ndjekin studimet e ciklit te trete te Doktoratures.
4. Te jetë i aftë të garantojë standartin e cilesise dhe efikasitetin ne pune.
5. Të ketë njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor (vleresohet me se shumti kandidati me eksperience studimi dhe mesimdhënie ne universitetet perendimore apo ne universitetet brenda vendit)
6. Te mos kete vepruar apo propoganduar ne veprim te prishjes se imazhit te universitetit.
7. Te plotesoje kriteret e punesimit te percaktuar ne statut dhe rregullore.

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e aplikimit për personel akademik i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën www.univlora.edu.al, ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Degës së Burimeve Njerëzore të Universitetit “Ismail Qemali” Vlore;
2. Fotokopje të diplomës, të noterizuar;
3. Fotokopje të çertifikatës së notave të noterizuar;
4. Fotokopje të dëshmime kualifikimi të ndryshme, të noterizuara;
5. Fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale,shkencore ose punime të tjera;
6. Fotokopje të pasaportës ose të një dokumenti identifikimi;
7. Deklaratë nga kandidati aplikues për gjëndjen gjyqësore dhe konfliktin e interesit;
8. Preferohen dhe tre letra vleresimi (jo domosdoshmerisht), nga vleresues me grada dhe tituj, njeri prej te cileve duhet te kete te pakten titullin Profesor i Asociuar ose PhD apo Profesor nga universitete perendimore ose te huaja te njohura.

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar ne nenin 92 te Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor ne institucionet e Arsimit te lartë në Republikën e Shqipërisë”.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Kriteret specifike jane percaktuar ne kerkesen e departamentit.

C. Afati i fundit i pritjes aplikimeve është 2 jave pas shpalljen ne APP. Njoftimi shpalljet ne website zyrtar dhe ne vendet e njoftimeve ne universitet.

D. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën;
Universiteti “Ismael Qemali”
Fakulteti: Shkencave Teknike
Departamenti: Departamenti i Kimise
Sheshi “Pavaresia” Skele-Vlore

E. Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.

F. Proçedura e konkurimit fillon menjëherë pas publikimit te vendit te lire te punes dhe perzgjedhja do të zhvillohet sipas percaktimeve ne Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Ismael Qemali” Vlore. Ne fazen e pare do te behet vleresimi i dosjeve dhe ne fazen e dyte do te jete intervista me punedhenesin.